

KLSH merr pjesë në tryezën e diskutimit “Vlerësimi i Sistemit të Vlerësimit të Performancës së Prokurorëve në Shqipëri: Problematika dhe Rekomandime”

Në datën 12 qershor 2024 u zhvillua tryeza e diskutimit me temë “Vlerësimi i sistemit të vlerësimit të performancës së prokurorëve në Shqipëri: Problematika dhe rekomandime”.

Ky panel diskutimi u organizua nga Qendra për Studimin e Qeverisjes dhe Demokracisë (CSDG), mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, me pjesëmarrjen e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, institucioneve shtetërore, si: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme, si dhe përfaqësuesve të institucioneve ndërkombëtare etj.

Aspekte të diskutimeve përfshinë metodologjinë e pikëzimit për efekt vlerësimi të performancës së prokurorëve dhe zbatimin në praktikë të kësaj metodologjie, ku u ngritën një gamë e gjerë pyetjesh e diskutimesh, mbi aspektet e zbatimit të saj për gjithë kriteret e vlerësimit. Lidhur me vlerësimin e performancës, diskutimet u bazuan në analizimin e informacionit të të dhënave statistikore të nevojshme për të zbatuar skemën e vlerësimit të performancës. Analiza synoi të evidentojë problematikat dhe treguesit që lidhen me vlerësimin në praktikë të performancës së prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm, mbështetur në pesë parametrat kryesorë që lidhen me: drejtësinë dhe objektivitetin, saktësinë dhe besueshmërinë, gjithëpërfshirjen, transparencën dhe përgjegjshmërinë si dhe orientimin drejt rezultateve.

Tryeza e punës ishte një hap i rëndësishëm drejt bërjes efektive dhe finalizimit të përmirësimeve të nevojshme në kuadër të vlerësimit të performancës së prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm. Në këtë panel diskutimi Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga z.Qeram Cibaku dhe z.Bledar Mustafaraj.